



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
AUDITIMI I BRENDSHËM

Nr _____ prot.

Gramsh, më ____/____/2020

Lënda: Relacion mbi plotësimin e pasqyrave të planit strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm Bashkia Gramsh.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Plan Strategjik prezanton **objektivat kryesorë**, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Bashkinë Gramsh për periudhën viti 2020-2022.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të riskut dhe në pajtim me Ligjin e Auditimit të Brendshëm, Standardet e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës së audituesve të brendshëm dhe Metodologjinë për auditimin e brendshëm në sektorin publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2020-2022 janë planifikuar për tu audituar subjekte me risk të lartë e të mesëm duke lënë për tu audituar ne periudhat e mevonshme auditime me risk të ulët.

HYRJE

Ky plan strategjik ofron bazën për zhvillimin e Planit Vjetor të aktivitetit të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

Gjatë përgatitjes së procesit të planifikimit ne fillim bëhet njohja me;

- Strukturën organizative të bashkisë.
- Pasqyrat financiare të drejtorisë së financës.
- Kuadrin e përgjithshëm dhe të posaçëm ligjor e rregullator.
- Sistemet dhe proceset e kontabilitetit dhe shkallën e përfshirjes së sistemeve kompjuterike.
- Regjistrin e riskut te Njesise vendore.

Planifikimi strategjik, përcakton punën që duhet kryer gjatë periudhës 3-vjecare, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik është përgatitur në mënyrë të tillë që të bëjë të mundur mbulimin me auditim të fushave e sistemeve të cilat janë më të ekspozuara ndaj risqeve në veprimtarinë e bashkisë.

Planifikimi vjetor ka si qëllim të mbajë të përditësuar Planin Strategjik.

Plani vjetor është dokumenti kryesor sipas të cilit do të kryhet veprimtaria e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit.

Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik.

Plani Strategjik është dokument i cili përcakton strategjinë për veprimtarinë e Auditimit e Brendshëm në bashki. Kjo strategji u përgatit për periudhën 2020-2022 nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshëm dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan.

Angazhimet e auditimit të brendshëm, në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre-vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave mbi bazë risku, si dhe burimet njerëzore të planifikuara në dispozicion të sektorit të Auditimit të Brendshëm

MISIONI

Misioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Gramsh është që të ndihmojë Kryetarin e Bashkisë për të arritur objektivat e vendosura për Bashkinë.

Përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë dhe subjekteve vartëse të saj .

- Rritjen e frytshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për sistemet e kontrollit brendshëm për përmirësimin e tyre, për të arritur objektivat e caktuara duke përdorur burimet në mënyrë ekonomike dhe eficiente.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Njësine publike është i organizuar si sektor në varësi të drejtpërdrejtë të kryetarit, dhe funksionon me një përgjegjës auditimi dhe një specialist auditimi emëruar më datë 07.10.2019.

Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshëm në Bashki.

1. Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
2. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditimit të Brendshëm”;
3. VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
4. VKM nr. 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitet publike”;
5. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”
6. Manuali i Auditimit të Brendshëm viti 2016.

Të gjitha këto do të ndihmojnë njësinë e AB-së të ndërtojë një pamje të asaj që organizata po përpiqet të arrijë, dhe të risqeve me të cilat përballet.

Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

-Gjatë hartimit të planit strategjik 2020-2022 janë planifikuar për tu audituar subjekte me risk të lartë e të mesëm duke lënë për tu audituar në periudhat e mëvonshme auditime me risk të ulët. Në planifikimin e nivelit të risqeve jemi bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi, fushat e veprimtarisë, buxhetin, burimet njerezore, periudhën e paaudituar, gjetjet e mëparshme të auditimit.

Sistemet që vlerësohen se kanë nivel të lartë të riskut, do të auditohen, një herë në vit si:

- Sistemet e menaxhimit të aseteve ,
- Sistemi i emergjencave civile,
- Sistemet e ndarjes detyrave, ndjekja e debitorëve, realizimi i të ardhurave sipas paketës fiskale në Njësitë Administrative,
- Gjobat, likuidimi, përputhshmëria me ligjet në sektorin e IMT-së. etj.

Identifikimin e subjekteve objekt auditimi.

Planifikimi strategjik në Bashki përfshin të gjithë sistemet e identifikuar. Sektori i Auditimit duhet ti japë përparësi për ato sisteme që do të auditohen, në mënyrë që:

- Sistemet që vlerësohen se kanë nivel të lartë të riskut, do të auditohen me frekuencë të rregullt, zakonisht një herë në vit.
- Sistemet me nivel të ulët të riskut mund të auditohen me frekuencë më të ulët, për shembull, një herë në dy vjet ose edhe më rrallë.

Planifikimi vjetor .

Hartimin e planit vjetor 2020 e mbeshtesim në këta tregues:

-Lista e auditimeve dhe subjektet që do ti nënshtrohen auditimit, si dhe një shpërndarje kohore të tyre gjatë vitit është hartuar sipas subjekteve, sistemeve, fushave të parashikuara për auditim si dhe sipas shpërndarjes së ditë njerëzve në dispozicion për vitin 2020.

Gjithsej janë zgjedhur dhe planifikuar për auditim 8 subjekte nga të cilat 6 janë subjekte 2 janë njësi administrative.

Llojet e angazhimit të auditimit.

Për hartimin e planit të veprimtarisë audituese për vitin 2020 u bazuam në strukturën e miratuar të sektorit dhe në kohen e punës që zë çdo proces pune audituese sipas stadeve të auditimit, që mund të kryej një auditues gjatë një viti. Për vitin 2019 u planifikuan për auditim 6 auditime, në sektorë të bashkisë, dhe 2 auditime në Njësi administrative.

Llojet e auditimit:

1. Auditim përputhshmërie 2.
2. Auditime të kombinuara 3
3. Auditim Financiar 2.

4.Auditim performance 1.

Shpërndarja e burimeve të AB dhe Kostoja për auditues.

Njësia e Auditimit në bashkinë Gramsh aktualisht perbehet nga **dy punonjës** në pozicionin përgjegjës auditimi, dhe specialist auditimi.

Auditimi i Brëndshëm do të mbështetet në burimet njerëzore aktuale për përmbushjen e angazhimeve të veçanta të miratuara nga Kryetari i bashkisë. Llogaritja është kryer bazuar në ditë pune të vlefshme në vit pa pushimet vjetore dhe festat zyrtare, si dhe auditues për vitin 2020.

Nga koha efektive e punës në ditë/njerës, janë zbritur ditë njerëz që nevojiten për pushimet vjetore, festat zyrtare, pushimet javore, pushime për arsye shëndetësore, trajnime dhe angazhime të tjera si takime, mbledhje etj

Nevoja për kualifikimin e audituesve të brendshëm.

Janë bërë llogaritjet për trajnim, duke planifikuar për trajnim disa nga temat që na duken më të arsyeshme.

**Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm
Lavdie Pashollari**

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË _GRAMSH

Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2020

			VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
I	Bashkia Gramsh	Drejtoria e menaxhimit financiar dhe kontrollit	x		
1		Spektori taksa- tregje	x		
2		Drejtoria Menaxhimit Burimeve Njerëzore	x		
3		Sek.sherb veterinar,mjedisit,bujqësisë.		x	
4		Drejtoria studim -projektimit		x	
5		Sek. IMT		x	
6		Sek.Menaxhimit Aseteve		x	
7		Drejtoria Juridike	x		
8		Spektori Mirëmbajtjes Rrugëve Rurale			x
9		Spektori kullimit -vaditës		x	
10		Agj, kulturës,sportit dhe arsimit			x
11		Spektori MNZSH	x		
12		Policia bashkiake		x	
13		Drejtoria e Shërbimit Pyjor		x	
14		Drejtoria shërbimeve,sek emergjenca,sek me sipërmarrje	x		
II	Njësitë administrative				
1		Njësia Administrative Kodovjat		x	
2		Njësia Administrative Tunje		x	
3		Njësia Administrative Lenie		x	
4		Njësia Administrative Poroçan		x	
5		Njësia Administrative Kushove		x	
6		Njësia Administrative Sult		x	
7		Njësia Administrative Skënderbegas		x	
8		Njësia Administrative Kukur		x	
9		Njësia administrative Pishaj		x	

Përgjegjësi Auditimit Brendshëm

Lavdie Pashollari

Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2020-2022

Nr	SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE					
	Viti planifikuar 2020	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti I planif+1 2021	Niveli i Riskut (V. planif +1)	Viti I planif+2 2022	Niveli i Riskut (V. planif +2)
a.	1	2		4	5	6
1	Spektori menaxhimit Aseteve	mesëm	Spektori taksa- tregje	I larte	Spektori aseteve	I lartë
2	Spektori IMT	mesëm	Njësia Administrative Kukur	I mesëm	Njësia Administrative Kushovë	mesëm
3	Spektori MNZSH	I lartë	Sekt.Sherbimeve komunale	I mesëm	Sek.Emergjencave Civile	I lartë
4	Njësi vartëse Cerdhe,Kopsht,konvikt	I mesëm	Spektori Financës	I lartë	Njësia Administrative Tunjë	I mesëm
5	Sek.veterinar,mjedis,bujqësi	I mesëm	Sek,Mirmbajtje Rrugëve	I mesëm	Drejtoria Burimeve Njerëzore	I mesëm
6	Sek.Emergjencave	I lartë	Njësia Administrative Skënderbegas	I mesëm	Sek.Cerdhe,Kopësht,Konvikt	I mesëm
7	Njësia Administrative Pishaj	mesëm	Njësia Administrative Sult	I mesëm	Spektori I MNZ	I lartë
8	Njësia Administrative Poroçan	mesëm	Njësia Administrative Lenie	I mesëm	Sek.IMT	I mesëm
			Drejtoria Planifikim territorit	I mesëm	kanalet vaditës	I mesëm
9						

Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm
Lavdie Pashollari

Plani i angazhimeve të NJAB për vitin _____ 2020

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulencës	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1	Bashkia Gramsh	Spektori menaxhimit Aseteve	1			1				2
2		Spektori IMT	1	1						2
3		Spektori MNZSH	1					1		2
4		Njësitë vartëse Çerdhe,Kopsht,konvikt	1			1				2
5		Sek.veterinar,mjedis,bujqësi	1	1						2
6		Sek.Emergjencave	1		1					
7	Njësi Administrative	Njësia Administrative Pishaj	1					1		
8		Njësia Administrative Poroçan	1					1		
9										
	SHUMA		8	2	1	2	0	3		

Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm
Lavdie Pashollari

Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2020

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr.personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohëzgjatja e trajnimit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Kryerja e një angazhim auditimi rast konkret.	2	Muaji Tetor	5ditë
2	Hartimi i planit strategjik dhe vjetor në bazë rrisku	2	Muaji Tetor	
3	Kryerja e auditimeve të bazuar në risk,duke u mbështetur tek regjistri i riskut i njësisë publike.	2	Muaji Tetor	
	SHUMA	2	Tetor	5

**Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm
Lavdie Pashollari**

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB per vit vitin : 2020

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA			Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlogaritja e burimeve		Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2	3		1	2
1	Koha maksimale e vlefshme	260x2	52x5x1	1	Buxheti Gjithsej	1763
2	Pushime Vjetore	20x2	20x1	2	Paga dhe Sig.Shoqërore	1703
3	Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	13x2	13x1	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	60
4	Pushime për arsye shëndetësore	5x2	5x1	4	Të tjera	0
5	Angazhime në trajnime	5x2	5x1	5	Numri i Punonjësve	2
6	Angazhime në mbledhje/takime	5x2	5x1	6	Kosto për Person	882
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	10x2	10x1			
	TOTALI	404	202 d/person			

Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm

Lavdie Pashollari